

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 29.04.2024, me të cilën kryesonte kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, në bazë të nenit 37 paragrafi (1), nënpika 2 të Ligjit të gjykatave ("Gazeta Zyrtare e RM" 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19), neni 67 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi Kërkesën e mendimit nga Ministria e Drejtësisë lidhur me Njoftimin e dorëzuar nga Banka popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Ministrinë e Drejtësisë, të evidentuar në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nën SU-03 nr.41/24 të datës 22.01.2024, nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Kërkesa për mendim, e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, e evidentuar nën SU-03 nr.41/24 të datës 22.01.2024, NUK MIRATOHET.

A r s y e t i m

Kryetares së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut i është dorëzuar kërkesë për mendim nga Ministria e Drejtësisë, lidhur me Njoftimin nga Banka popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Ministrinë e Drejtësisë, për ndryshime ligjore të nevojshme të Ligjit për konteste administrative, dhe në lidhje me zbatimin praktik të Ligjit të bankave dhe Ligjit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi banka, si çështje e iniciuar nga Banka popullore dhe Fondi monetar ndërkombëtar.

Në arsyetimin e kërkesës theksohet se nevojitet që nenit 14 ti shtohet një paragraf i ri (3) të Ligjit për konteste administrative që ka të bëjë me zbatimin adekuat të dispozitave të rregullave tjera, me futjen shtesë të dispozitës së posaçme për veprimin e Gjykatës Administrative, në lidhje me paditë e parashtruara kundër akteve të Bankës popullore të sjella në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankave (sipas dispozitave të Ligjit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi banka), përkatësisht kundër akteve të Bankës popullore që kanë të bëjnë me lejen për themelimin dhe punën dhe për plotësimin e kushteve të procedurës për falimentim dhe likuidim (sipas dispozitave të Ligjit të bankave).

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit të gjykatave, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Seancën e përgjithshme, jep mendime me propozim të ligjeve dhe rregulla tjera kur me to rregullohen çështje të rëndësishme për punën e gjykatave.

Në bazë të nenit 67 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme, Seanca e përgjithshme jep mendime mbi Propozime të ligjeve dhe rregullave tjera, me të cilat rregullohen çështje të rëndësishme për punën e gjykatave, drejtuar propozuesit të ligjit përkatësisht rregullës.

Sipas dispozitave të sipërcituara të Ligjit të gjykatave dhe Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk e miratoi Kërkesën për mendim nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me Njoftimin e dorëzuar nga Banka popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Ministrinë e Drejtësisë, të evidentuar në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nën SU-03 nr.41/24 të datës 22.01.2024, pasi që Kërkesa nuk është paraqitur me propozim ligj apo me ndonjë rregull tjetër për të cilat Seanca e përgjithshme është kompetente të jep mendim.

Seanca e përgjithshme
e Republikës së Maqedonisë së Veriut